

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - SHËRBIM**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**Objekti i prokurimit: “FISKALIZIM I FATURVE ELEKTRONIKE TE NDERMARRJES  
UJESJELLES KANALIZIMEVE SH URA VAJGURORE”**

**Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): 48444100-3**

**Vlera e fondit limit:** 4 166 667 (katër milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë)) Lek pa Tvsh

**Argumentimi:** Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Dimal, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

**2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

**2.1.1** Kjo pikë e kriterëve plotësohet me Kriteret e përgjithshme të pranimit/ vecanta te kualifikimit të plotësuar më sipër. (Shtojcat).

**2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020 dhe 2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit objekt prokurimi.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është vendosur bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është kufirin e ulët monetar dhe kërkohej një operator ekonomik i cili të ketë minimumin e kërkuar duke marrë në konsideratë objektin e kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

**2.2.2** Operatori Ekonomike ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se subjekti i ka plotësuar të gjitha detyrimet të maturuara të taksave dhe tarifave vendore të vitit 2021, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument.

*Shenim: Kjo kërkesë permbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit permbledhës të vetedeklarimit sipas shtojcës perkatëse të DST-se dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatëve të ankimimit,*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenin 43, nenin 41, pika 5/ c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

Meqenese operatorët ekonomik kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, në një vlerë jo më të vogël se 39 % të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës

Këto shërbime të ngjashme duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a-Kur shërbime të ngjashme janë realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara

*ose*

b-Kur shërbime të ngjashme janë realizuar me subjekte private si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë jo më të vogël se 39% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Përvoja e mëparshme është element shumë i rëndësishëm që garanton autoritetin kontraktor, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së shërbimeve të ngjashme zotërojnë kapacitete të nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses.

**2.3.2** Operatori Ekonomik ose te pakten nje ekspert nga stafi teknik i OE, duhet te disponoje Çertifikate regjistrimi te drejtes se autorit per te pakten nje veper ne fushen e teknologjise se informacionit sipas ligjit nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”.

Per te permbushur kete kriter OE duhet te paraqese Çertifikaten e regjistrimit te drejtes se autorit.

*Shenim: Nese OE-te disponojne ne stafin teknik te pakten nje ekspert, i cili duhet te figuroje ne listpagesa te pakten per periudhen Korrik 2022 – Tetor 2022, si dhe i pajisur me Çertifikate regjistrimi te drejtes se autorit per te pakten nje veper ne fushen e teknologjise se informacionit, kjo kerkese permbushet duke paraqitur kete dokument ne SPE ose nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimit.*

**Argumentimi:** Ky kriter eshte vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe bazuar ne ligjin nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë ose nje ekspert nga stafi teknik i OE duhet te disponoje Çertifikate regjistrimi te drejtes se autorit per te pakten nje veper ne fushen e teknologjise se informacionit.

Kjo kerkese e AK-se eshte vendosur duke marre ne konsiderate rendesine e vecante qe ka ky sherbim si dhe duke qene se me ane te sistemit qe kerkohej te realizohet do te menaxhohen te ardhurat e institucionit dhe do te administrohen te dhenat personale te subjekteve dhe individeve qe ushtrojne veprimtari ne Bashkine Dimal. Disponimi i nje Çertifikate regjistrimi te drejtes se autorit per te pakten nje veper ne fushen e teknologjise se informacionit eshte nje garanci per AK-ne se te dhenat personale te subjekteve dhe individeve do te menaxhohen nga OE apo individe qe jane te certifikuar nga institucione kombetare ne prodhimin e veprave ne fushen e teknologjise se informacionit.

Gjithashtu kjo kerkese vleresohet e rendesishme per AK, pasi duke marre ne konsiderate preblemet e sistemeve elektronike nga sulmet e hackerave ne mesin e muajit korrik te vitit 2022, nevojitet qe per keto vepra ne fushen e teknologjise se informacionit te kontraktohen operator ekonomike te certifikuar nga institucione kombetare.

Po ashtu, me qellim dhenien mundesi sa me shume operatoreve ekonomike eshte lene e hapur qe ky kriter permbushet edhe nese OE-te disponojne ne stafin teknik te pakten nje ekspert i cili eshte

i pajisur me Çertifikate regjistrimi te drejtes se autorit per te pakten nje veper ne fushen e teknologjise se informacionit.

**2.3.3** Operatori Ekonomik ofertues duhet të kete te punesuar të paktën 9 (nente) punonjës për periudhën Korrik 2022 – Tetor 2022, të vërtetuar me:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqerore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën Korrik 2022 – Tetor 2022.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Korrik 2022 – Tetor 2022.

*Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.*

**Argumentimi:** Ky kriter eshte vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit te mesiperme per numrin minimal te punonjesve, është në përputhje me llojin e shërbimit te kerkuar. Po t’i referohemi termave te references, qellimit dhe kerkesave per kete shërbim është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve.

Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, , personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

**2.3.4** Operatori Ekonomik ofertues për të vërtetuar që disponon kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë dhe sipas specifikimeve teknike dhe termave të References të shërbimit, duhet të disponojë minimalisht staf të certifikuar si me poshte:

a) 1 (një) punonjës të certifikuar si menaxher projekti PMP ose ekuivalente

b) 1 (nje) Ekspert i certifikuar nga prodhuesi në zhvillimin e zgjidhjeve informatike.

Per te permbushur kete kriter OE duhet te paraqese te pakten njerën nga certifikatat në vijim:

- Microsoft Certified Solution Developer, **ose** Oracle Certified Associate, Java SE 5/SE 6/ SE7, **ose** certifikatat ekuivalente, të leshuar nga provider i teknologjise se zgjidhjes nese zgjidhja ofrohet në nje teknologji tjetër.

c) 1 (nje) Ekspert i certifikuar nga prodhuesi në zhvillimin e aplikacioneve.

Per te permbushur kete kriter OE duhet te paraqese te pakten njerën nga certifikatat në vijim:

- Microsoft Certified Application Developer, **ose** Oracle Certified Professional, Java SE 5/SE 6/ SE7 Programmer, **ose** certifikatat ekuivalente, të leshuar nga provider i teknologjise se zgjidhjes nese zgjidhja ofrohet në nje teknologji tjetër.

d) 1 (nje) Ekspert i certifikuar nga prodhuesi në administrimin e bazave të të dhënave.

Per te permbushur kete kriter OE duhet te paraqese te pakten njerën nga certifikatat në vijim:

- Microsoft Certified Database Administrator, **ose** Microsoft Certified Solution Expert Data Platform, **ose** Oracle Certified Professional, **ose** IBM Database Administrator **ose** certifikatat ekuivalente me te, të leshuar nga provider i teknologjise se zgjidhjes nese zgjidhja ofrohet në nje teknologji tjetër.

e) 1 (nje) Ekspert i certifikuar nga prodhuesi në administrimin e sistemeve të operimit dhe të infrastruktures.

Per te permbushur kete kriter OE duhet te paraqese te pakten njerën nga certifikatat në vijim:

- Microsoft Certified System Engineer, **ose** Microsoft Certified Solution Expert, Server Infrastructure, **ose** certifikatat ekuivalente me te, të leshuar nga provider i teknologjise se zgjidhjes nese zgjidhja ofrohet në nje teknologji tjetër.

f) Të paktën 1 (nje) specialist të diplomuar në Shkenca Elektronike/Kompjuterike/Informatike, me njohuri të certifikuar për Baza të Dhënash (Databaze).

Per te permbushur kete kriter OE duhet te paraqese diplomën dhe certifikatën perkatese.

g) Të paktën 1 (nje) specialistë të diplomuar në Shkenca Kompjuterike/Informatike me njohuri të certifikuar si Programues/Zhvillues.

Per te permbushur kete kriter OE duhet te paraqese diplomën dhe certifikatën perkatese.

h) Të paktën 1 (nje) punonjës të certifikuar nga Prodhuësi për Zhvillim Aplikacionesh ose ekuivalente

Per te permbushur kete kriter OE duhet te paraqese çertifikaten perkatese.

- i) Nje udheheqes per sigurine e informacionit i diplomuar ne shkenca kompjuterike apo elektronike. Duhet te deshmoje se ka aftesite e duhura me ane te certifikimeve te meposhtme ose ekuivalente.
- ISO 27001 – Lead Auditor. Certified
  - CHFI – Certified Hacking Forensic Investigation

Per plotesimin e ketyre kritereve OE-te duhet te paraqesin: Kontratat e punes, Çertifikatat ose traskriptet përkatëse ose diplomat, sipas shenimeve perkatese per cdo kriter te mesiperm (a-h), si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë të paktën për periudhën Korrik 2022 – TETOR 2022.

*Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit*

**Argumentimi:** Ky kriter eshte vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Po ashtu bazuar edhe ne termat e references te kesaj procedure, per realizimin e sherbimit kerkoher ekspertiza e nevojshme ne krijimin dhe implementimin e nje sistemi efikas dhe ne perputhje me politikat e sigurise, qe te aplikohet dhe te nderthuret me sisteme te tjera si e-albania, institucione financiare etj.

Per implementimin dhe menaxhimin me cilesi te tyre eshte e domosdoshme qe Operatori Ekonomik te kete ne stafin e propozuar personel te çertifikuar si me siper dhe te pajisur me certifikatat dhe diplomat përkatëse per zhvillimin e zgjidhjeve informatike, per zhvillimin e aplikacioneve, per administrimin e bazave te te dhenave, per administrimin e sistemeve te operimit dhe te infrastruktures, me njohuri të certifikuara si Programues/Zhvillues, sigurise se informacionit etj.

Numri i ekspertave te kerkuar perllogaritet duke u bazuar ne sherbimin e kerkuar ne dokumentin e termave te references dhe kerkesave teknike per kete sherbim krahasuar me nevojen dhe rendesine qe ka ky sherbim per AK, pasi nje numer me i vogel punonjesish do te krijonin rrezik ne permbushjen ne kohe te kerkesave funksionale te Autoritetit Kontraktor.

Ne lidhje me llojin e çertifikimeve është lene e hapur, me kushtin që të jenë çertifikuar nga prodhues, pasi me ane të shërbimit që kërkohej do të krijohet një sistem që do të administrojë të ardhurat e institucionit.

Sa me sipër me qëllim realizimin e shërbimit në përputhje me specifikimet teknike dhe zbatimin me sukses të kontratës si dhe realizimi i këtij shërbimi Brenda afatit të kërkuar, nevojitet minimalisht stafi i kërkuar.

**2.3.5** Operatorët Ekonomikë ofertues duhet të jetë i Çertifikuar sipas standarteve ISO të leshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilat duhet të jetë në të njëjtën fushë në kategorinë dhe specifikën e shërbimit që prokurohet konkretisht:

- ISO 9001:2015 – mbi “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë”, ose ekuivalentin e saj
- ISO 27001:2013 – mbi “Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit” ose ekuivalentin e saj
- **Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 41, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Referuar natyrës së veçantë, të objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët që do të realizojnë shërbimin, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë, sigurisë së informacionit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, menaxhimit të sigurisë së Informacionit, shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat që ka objekt veprimtarie sipas objektit të prokurimit dhe ka qëllim zbatimin me korrektesë të dispozitave ligjore në tre fushat e sipërcituara.
- Nisur nga proceset e punës kritike, rëndësia së platformës dhe shërbimeve që ai ofron, gjykohet e arsyeshme që operatori ekonomik në proceset e punës së tij, të bazojë në standarde europiane dhe/ose ndërkombëtare, të cilat në mënyrë direkte ndikojnë në cilësi, shpejtësi dhe efikasitet.
- Sistemi i menaxhimit të cilësisë siguron që operatori zotëron aftësitë për të ofruar shërbime që plotësojnë pritshmëritë e kërkesat dhe specifikimet e klientit përmes aplikimit efektiv dhe cilesor të tij.
- Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit siguron që operatori ekonomik aplikon, mirëmban dhe përmirëson në mënyrë të vazhdueshme një përjasje sistematike në menaxhimin e informacionit sensitiv me fokus tek siguria
- Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës për sa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**